



№-98/1 Prot
Dt. 17.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT KORÇË

**RAPORT MONITORIMI
I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT
TË DREJTORISË SË UJITJES DHE KULLIMIT,
KORÇË
PËR VITIN 2025**

TABELA E PËRMBAJTJES

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

II. QASJA VLERËSUESE

III. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

IV. GJETJET E RAPORTIT

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani Integritetit përbën një instrument të luftës kundër korrupsionit, i cili i shërben institucionit në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së risqeve që cenojnë integritetin. Forcimi i integritetit dhe miratimi i masave sistematike antikorrupsion janë të rëndësishme në kuadër të reformave të administratës publike, për arsye se nëpërmjet tyre synohet të garantohet një administratë publike profesionale, me etikë, integritet dhe performancë të lartë.

Plani Integritetit të D.U.K Korçë për vitet 2025-2027, përfshin një analizë të vlerësimit të risqeve të integritetit në institucion, si dhe parashikon masa konkrete për zbatim, me qëllim përmirësimin e efikasitetit, transparencës, llogaridhënies, rritjen e besueshmërisë publike, si dhe arritjen e objektivave strategjike e specifike të institucionit.

Përballja efektive me korrupsionin për Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit Korçë është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë ka përgjegjësinë kryesore për mbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja në kushte të përshtatshme të operimit, për rritjen e jëtgjatësisë së përdoimit të tyre, me kosto më të ulët të mundshme, pasi, pa një nivel të përshtatshëm të mirembajtjes, kjo infrastrukturë, do të shkatërrohet, operimi do të bëhet më i vështirë dhe do të kemi më pak uje për ujitje, më pak mundësi për largimin e ujërave të kullimit dhe përmbytje më të shpeshta, me ndikim në uljen e prodhimeve bujqësore dhe të ardhurave të fermerëve.

Duke pasur një rol qendror në këtë fushë, jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi ndër të parët që të japim shembullin për t'i shërbyer interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj. Ky plan integriteti është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit pro-aktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion.

Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Korçë dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e cilësisë së punës së institucionit dhe të ofrimit të shërbimit për qytetarët.

Jemi të ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtësisë, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etiken, do të sigurojnë zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin e publikut tek ne.

Qëllimi i Planit të Integritetit në këtë institucion është: a) vlerësimi i risqeve të integritetit të cilat komprometojnë performancën dhe llogaridhënien e DUK Korçë për të kryer funksionin e shërbimit publik (mirembajtjen dhe pastrimin e kanaleve kullues, argjinaturave dhe kanale të ujerave të larta KUL) si dhe b) formulimi i masave të përshtatshme për adresimin e tyre dhe përmirësimin e funksionimit të institucionit.

Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre është kryer për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë së institucionit. Këto fusha përfshijne: menaxhimin financiar; prokurimin publik; menaxhimin e burimeve njerëzore; kontrollin, auditimin dhe mekanizmat kundër korrupsionit; transparencën; arkivimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve dhe informacionit.

Në përputhje me Planin e Integritetit, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, D.U.K Korçë ka hartuar Raportin e monitorimit për vitin 2025, mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente. Monitorimi i Planit të Integritetit është një fazë e rëndësishme, për arsye se shërben për të vlerësuar nëse risqet e identifikuara janë menaxhuar në mënyrë efektive, si dhe për të konstatuar nëse janë realizuar aktivitetet dhe masat e parashikuara në planin e veprimit.

Raporti monitorimit të Planit të Integritetit për vitin 2025, jep të dhëna mbi zbatimin e objektivave dhe masave të parashikuara për periudhën e kërkuar, progresin e zhvilluar në kuadër të rritjes së transparencës, si dhe masat e ndërmarra për plotësimin dhe rishikimin e legjislacionit në fuqi, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e integritetit.

Në Planin e Integritetit për vitin 2025, janë parashikuar për zbatim 13 masa, ku rezulton se gjatë vitit 2025 janë realizuar 11 masa dhe 2 masa janë në proces realizimi.

II. QASJA VLERËSUESE

Raporti monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit përmban një analizë të përgjithshme të performancës institucionale për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit, ku përcaktohet niveli i realizimit të masave të parashikuara në plan, si dhe hapat konkretë që janë ndërmarrë nga drejtoritë përgjegjëse për përmbushjen e tyre brenda afatit.

III. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Raporti monitorimit është hartuar në bazë të kontributit të sektorëve të D.U.K Korçë për të cilat ka patur të parashikuara masa për zbatim për periudhën e kërkuar. Secili sektor ka raportuar mbi statusin e realizimit të masave, nëse janë realizuar plotësisht, vijnë në proces dhe veprimet konkrete që janë ndërmarrë për përmbushjen e tyre. Të dhënat e këtij raporti janë mbledhur nga Koordinatorin e Integritetit, në përmbushje të rolit të tij, si personi i caktuar për hartimin e Raportit të monitorimit.

Sektorët/ Personat përgjegjës që kanë raportuar janë si më poshtë vijon:

- Sektori i Financës – Zhuljeta Asko;
- Sektori Teknik – Anesti Lubonja;
- Sektori Hidrovor dhe Makineri e Rëndë – Artan Lavdari;
- Sektori Elbasan – Klejdi Maçi;
- Sektori Berat – Avdulla Salillari.

IV. GJETJET E RAPORTIT


Monitorimi i zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Integritetit është një hap i rëndësishëm për të garantuar integritetin institucional. Konkretisht nëpërmjet hartimit të raportit të monitorimit synohet:

- Mbikëqyrja e vazhdueshme e nivelit të zbatimit të masave të parashikuara në plan;
- Forcimi i llogaridhënies publike dhe transparencës në institucion, për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike;
- Rishikimi dhe plotësimi i vazhdueshëm i legjislacionit ligjor në fuqi, me qëllim përmirësimin dhe forcimin e integritetit.

Nga të dhënat e sektorëve raportuese të Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Korçë, rezulton se:

Në Planin e Integritetit për vitin 2025, janë parashikuar për zbatim 13 masa, ku rezulton se gjatë vitit 2025 janë realizuar 11 masa dhe 2 masa janë në proces realizimi.

ZBATIMI I MASAVE PËR VITIN 2025



Objektivat strategjikë të Planit të Integritetit 2025-2027 janë si mëposhtë:

- 1- Vënien në gadishmëri të infrastruktures ujitese, kulluese, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja, sipas përcaktimeve të nenit 5.
- 2- Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, digat dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja, që të plotësojnë nevojat për ujë për ujitje, të largojë ujin e tepërt, të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit dhe të parandalojë përmbytjen.
- 3-Me fondet vjetore (shpenzime dhe investime), të planifikuara për infrastrukturën ujitese, kulluese dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja, në administrim:
 - a. pastron dhe mirëmban kanalet ujitëse dhe kulluese si dhe veprat e artit,
 - b. shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të ujitjes dhe kullimit,
 - c. reabilton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit si dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja,
 - d. mbikqyr sigurinë e digave të rezervuareve për ujitje dhe kur është e nevojshme kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre,
 - e. merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar (rregullimet ose dëmet në të),
 - f. merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet,
 - g. përmbush detyrat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve ujore,
 - h. monitoron sasinë e ujit që përdoret gjatë një viti,
 - i. harton grafik të ujitjes dhe bashkëpunon për planifikimin e nevojave për ujë për ujitje, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe kullimit, me strukturat përkatëse të menaxhimit të burimeve ujore.
- 4-Kryen kontrollet teknike të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja dhe ndërmerr veprimet përkatëse për ruajtjen e sigurisë dhe sjelljen e tyre në kushtet e projektit si më poshte.

a. per digat e ujëmbledhësve:

Përvec mbikqyrjes së zakonshme dhe detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8681, datë 01.11.2000 Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave "Vendimi i këshillit të Ministrave nr 147, dt. 18.03.2004" Për miratimin rregullores "Për sigurinë e digave dhe dambave" dhe udhëzimeve të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

- kontrollohet kurora e digës,
 - kontrollohet gjëndja e shpatinave, veshjet e saj dhe masa të tjera për mbrojtjen nga gerryerja;
 - kontrollohet gjëndja e shkarkuesit katastrofik, ujelëshuesit, saraqineskave, portave dranaxheve, etj, vërehet nëse ka në trupin e digës dhe në terrenin përreth shënja plasaritjesh, filtrimesh, shkarjesh, etj,
 - hartohet plani i alarmit, evakuimit dhe ndihmës për mbrojtjen e popullatës dhe të vlerave materiale në rastet e jashtëzakonshme, si pasojë e prishjes së digave dhe dambave,
 - Krijohet njësia e drejtimit teknik të monitorimit të digave të rezervuarëve, e cila.:
- a) Merr masa për hartimin dhe plotësimin e "Regjistrat të shfrytëzimit të digave" për mbikqyrjet,

vrojtimet, matjet, përpunimin e të dhënave dhe interpretimin e tyre.

- b) Mer masa për sigurimin e menjëhershëm të projekteve të zbatimit për ndërtimin e digave, dambave dhe argjinaturave, hedhjen e të dhënave teknike në librin përkatës përkatësisht për këta elementë
- Trupi i digës/dambës
 - Drenazhet
 - Bazamenti
 - Skrapatet
 - Kurora e diges /dambës
 - Elementet e papërshkueshmërisë
 - Vëllimi i vdekur
 - Vëllimi i shfrytëzueshëm
 - Vëllimi i përpunimit
 - Rezerva nga niveli maksimal deri në kurorë
 - Brigjet që e rrethojnë atë
 - Sistemet e devijimit
 - Sistemet e shkarkimit
 - Sistemet e marrjes
 - Sistemet e zbrazjes
 - Sistemet e furnizimit
 - Godina e shërbimit dhe ruajtjen

Për të kontrolluar mirëfunksionimin e digave :

vizita dhe kontrole periodike vizuale në objekt dhe ambjentet rreth tij, kontrollojnë

c) sistemet e shkarkimit, zbrazjes dhe marrjes së ujit,

ç) Kontrolli vizual do të bëhet në:

- Kontrollin e kurorës së digës, nëse ka ulje, deformime, mbirje pemësh, etj
- Kontrollin e shkarkuesit, nëse ka bllokime apo ngushtim seksioni diga materiale të ndryshme, erozioni, korozioni, etj.
- Kontrollin e shuarësit të energjisë, nëse ka gërryerje apo deformime të ndryshme
- Kontrollin e kontaktit të digës me brigjet, nëse ka rrjedhje, erosion.
- Kontrollin e qëndrueshmërisë së brigjeve të ujëmbledhësit, nëse ka rrëshqitje, erosion.
- Kontrollin e aftësisë tërheqëse të prurjes maksimale në anën e poshtme të digës, nëse ka ngushtime seksioni, rrëshqitje, ridëmtime të pa kontrolluara ,etj.
- Kontrole nëpërmjet matjeve të aparaturave të vendosura në objektet dhe nën objekt sipas projektit.
- Për të gjitha korrollet e ushtruara, një herë në tre muaj, harton raportin për mirëmbajtjen dhe eliminimin e dëmtimeve të vogla, grafiket e matjeve, rezultatet e interpertimeve.

d) Në fund çdo muaji për të gjitha kontrollet e ushtruara në diga, përpilohet proces verbal për çdo objekt, ku paraqitet gjëndja sipas sistemeve të kontrolluara si më sipër, i jepen përgjegjësit të

sektorit teknik, i cili informon Drejtorin.

- e) Në mënyrë të vazhdueshme, harton dhe plotëson *"Regjistrin e shfrytëzimit"* për mbikqyrjet, vrojtimet, matjet, përpunimin e të dhënave dhe interpretimin e tyre, duke shënuar në regjistër sipas datave, ngjarjet gjatë shfrytëzimit të objektit dhe ujëmbledhësit, si mbushjet, zbrazjet, shkarkimet, manovrimet e portave, matjet, kontrollet, incidentet që konstatohen (filtrime, rrjedhje uji, plasaritje, etj), ngjarjet hidrometeorologjike të veçanta, lëkundjet sizmike dhe pasojat e tyre, punimet e mirëmbajtjes, përmirësimit dhe riparimet e kryera në objekt si dhe çdo gjë tjetër që duhet të regjistrohet.
- f) Të marrë masa që për çdo ndryshim që behet në legjislacionin dhe në rregulloret e miratuara nga organet shtetërore, të reflektohen në *"rregulloren teknike të shfrytëzimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit të objekteve dhe nën objekteve"*.
- g) Të marrë masa që para fillimit të sezonit të shkarkimeve, të kontrollohet funksionimi i të gjitha nën objekteve të shkarkimit e të boshatisjes së ujëmbledhësit deri në vendet ku shuhet efektet e shkarkimeve, duke marrë masat përkatëse për mangësitë që konstatohen, me afate të përcaktuara për vënien në gadishmëri të plote të tyre.
- h) Kontrollohen tre herë në vit pjesë e poshtme të rrjedhes, në raste të konstatimit të pengesave të shkarkimeve, merr masat e duhura për ritje shkarkim normal dhe sipas rëndësisë së situatës së paraqitur njofton përgjigjësin e sektorit teknik.
- i) Bën regjistrimin e niveleve të ujit në ujëmbledhesa, prurjet e lumit që ushqejnë ujëmbledhesin, shkarkimet, duke bërë dhe krahasimet me të dhënat në projekt.
- j) Harton preventivat për nevojat me bazë materiale dhe shpenzime për mirëmbajtjen, dhe ja paraqet përgjigjësit të sektorit teknik.
- k) Mbi bazën e kontrolleve, vrojtimeve, nxjerr konkluzione për gjendjen teknike të digave, si dhe propozon masa për ndërhyrje, për kryerjen e investimeve, dhe ja paraqet përgjigjësit të sektorit teknik.

c) *Per digat mufatese në shtratin e lumenjve:*

- Nivelohen pikat karakteristike për të parë a ka dëmtime
- Nivelohet profili tërthor i shtratit të lumit para dhe pas veprës për të parë a ka gërryerje.
- Vërehet a ka dëmtime, shkarje, filtrime, gërryerje, etj.
- Kontrollohen pjesët prej betoni ose guri të mbuluara me ujë për të parë a ka gërryerje apo dëmtime.
- Kontrollohet funksionimi i portave e mekanizmave të leshimit të ujit.

d) Për veprat e mbrojtjes nga përmbytja

Kontrolli dhe mirëmbajtja e veprave të mbrojtjes nga përmbytja, argjinaturave/pendeve duhet të garantojë mbrojtjen e tyre nga dëmtimet, mbajtjen në gadishmëri të plote për të përballuar prurjet e parashikuara në projektet përkatëse dhe pas çdo dëmtimi sa do të vogël, rivendosjen me rëptësi të kushteve të projektit, duke i konsideruar këto veprime si një minimum i domosdoshëm, Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit duhet të:

- Siguroj ndreqjen e dëmtimeve që pësojnë argjinaturat/pendët për shkaqe të ndryshme

Vendos reperat e kuotave, guret kilometrik, lata hidrometrike, shenjat e niveleve karakteristike, mbajtjen në rregull dhe vazhdimisht të azhurnuar të dokumentacionit teknik të argjinaturave/pendeve që administron,

- Mirembaje rrugët e shërbimit të pendëve dhe argjinaturave,
- Përpunojë në kushtet konkrete të argjinaturave/pendeve të ndryshme, përvojën që krijohet gjatë mirëmbajtjes, të kalimit të plotave dhe në përputhje me këtë të përcaktojë dhe zbatojë masat përkatëse dhe bërjen e propozimeve që shihen të nevojshme,
- Ndalojnë kalimet e automjeteve, mekanizmave të ndryshme mbi argjinaturat, me përjashtim të rasteve kur në projekt parashikohet, që këto të shërbejnë edhe si rrugë e mjeteve që punojnë. Kalimi i automjeteve, i mekanizmave dhe bagetive, tërthor argjinaturave/pendëve, të lejohet vetëm në vende kalimi të posaçme të përcaktuara. Për mbrojtjen e pendëve nga ana e jashtme të mbillen breza pyjore, jo më afër se 4 metra nga rreza e brinjës së argjiriatures/pendes, Ndalohet mbjellja e çdo lloji druri në trupin e argjinaturave/pendëve dhe në brezin 4 meter të gjere të matur nga rreza e brinjës së argjinaturave/pendëve nga ana e ujit, Gjatë kalimit të prurjeve të mëdha të lumenjë, njoftohet për prurjet e ujit referuar treguesve të pikave hidrometrike.
- Gjatë kalimit të plotave të mëdha të lumenjve mbikqyret niveli i ujit që përcakton gjendjen e mbikqyrjes për të cilën fillon monitorimi dinamik i rrjedhës së ujit dhe mbikqyrjen e nivelit ku fillon gjendja e rrezikut për të marrë masat përkatëse në zonën e rrezikuar.

- kontrollohet gadishmeria teknike e elektromotorreve, pompave, paisjeve elektrike teleshimit, transformoret, siguresat dhe çelsat e tensionit te mesëm dhe te ulet, tokezimi, etj.
- Kontrollohet mirembajtja dhe shfrytezimi i hidrovorëve sipas rregullave te percaktuara me Urdhrin e Ministrit Nr. 287, date 12.06.2006 “Per Miratimin e Rregullores se Shfrytezimit dhe Administrimit të Stacioneve te Kullimit me Elektropompa Aksiale Hidrovoret”.

e) Për stacionet e pompimit të ujitjes

- Kontrollohet gjendja e ndërtesës (vaskat ne hyrje dhe në dalje, tubacioneve te thithjes dhe dërgimit, zgarat metalike, bazaintetet ku bazohen pompave, kollonat, mbulesa e sipërme, që dimë në strukturen ndërtimore, etj.)
- Kontrollohet gadishmëria teknike e elektromotorrëve, pompave, paisjeve elektrike të lëshimit, transformatorët, siguresat dhe çelesat e tensionit të mesëm dhe të ulët, tokëzimi, etj.
- Kontrollohet mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i stacionit të pompimit të ujitjes.

OBJEKTIVI 1

“Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të Sistemit të ujitjes”

“Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të Sistemit të ujitjes” përbën një ndër objektivat kryesor që synohet të përmbushet. Ky objektiv paraqet një rëndësi thelbësore, për arsye se nëpërmjet një procesi transparent, garantohet zhvillimi dhe menaxhimi i Sistemit të ujitjes dhe rritet besueshmëria publike mbi veprimtarinë e institucionit.

Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi gjatë periudhës raportuese, janë realizuar masat si vijon:

- Përdorimi eficient i fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për përmirësimin e administrimit të sistemit të ujitjes, duke ndjekur me përpikmëri udhëzimet për rehabilitimin, modernizimin dhe zhvillimin e skemave të ujitjes.

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Korçë për vitin 2025 ka përdorur me efikasitet fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për përmirësimin e administrimit të sistemit të ujitjes ku konkretisht kemi pastruar kanalet ujitëse sipas planifikimeve dhe emergjencave.

- Ndjekja e një procedure efikente për identifikimin e nevojave për rehabilitimin e sistemeve të ujitjes dhe për përparësitë e kryerjes së punimeve.

Përgjegjësi i Sektorit Teknik, Përgjegjësi i Sektorit Elbasan, Përgjegjësi i Sektorit Berat dhe punpunjësit e secilit sektor janë vazhdimin në terren për identifikimin e nevojave dhe kanaleve që paraqesin

problematika dhe kanë nevojë emergjente për ndërhyrje. Këto konstatime raportohen tek Titullari i Institucionit dhe më pas është bërë renditja për ndërhyrje sipas përparësisë së rëndësisë së problematikës.

- Koordinimi i Planit Vjetor të menaxhimit të skemave ujitëse me Planin e Shërbimit të Ujitjes me pushtetin vendor

Sektori Teknik i D.U.K Korçë është në kontakt të vazhdueshëm dhe i hapur për të koordinuar punën si me pushtetin vendor ashtu dhe me Prefekturën me të cilin raportojmë çdo muaj planifikimet dhe planet e punimeve/pastrimeve në skemat ujitëse.

- Koordinim i punës me Njësitë e Ujitjes dhe Kullimit të bashkive, me qëllim hartimin e identifikimin e përparësive për sistemin e ujitjes, nisur kjo nga identifikimi i kërkesave për nevoja para se të fillojë sezoni i ujitjes.

Për vitin 2025 nisur nga kërkesat e sektorëve, të fermerëve dhe të njësive administrative/Bashkive, kemi kryer pastrimet e kanaleve të Rezervuarit të Gjançit në të dyja krahët (të majtë/të djathtë) në Bashkinë Korçë dhe kanalit të Polis Tudanit në Bashkinë Elbasan duke ia dorëzuar bashkive në datën 15 Maj në mënyrë që Bashkia ta përdor për vaditje në sezonin e ujitjes.

OBJEKTIVI 2

“Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të Kullimit”

Ky objektivi synon të sigurojë që sistemi i kullimit të funksionojë në mënyrë efikase, të qëndrueshme dhe afatgjatë, duke përmbushur nevojat aktuale pa kompromentuar ato të së ardhmes.

Së pari, arritja e rezultateve optimale lidhet me përdorimin sa më efikas të burimeve financiare, teknike dhe njerëzore. Kjo nënkupton projektimin e mirë të rrjeteve kulluese, mirëmbajtjen e rregullt të kanaleve, pompave dhe infrastrukturës përkatëse, si dhe përdorimin e teknologjive bashkëkohore për monitorim dhe menaxhim. Një sistem kullimi optimal minimizon rrezikun e përmbytjeve, përmirëson kushtet për bujqësinë dhe ndikon drejtpërdrejt në rritjen e produktivitetit.

Së dyti, qëndrueshmëria ka të bëjë me aftësinë e sistemit për të funksionuar në mënyrë të vazhdueshme në kohë, pavarësisht ndryshimeve klimatike, presioneve mjedisore apo zhvillimeve urbane. Kjo kërkon një qasje të integruar që përfshin:

- mirëmbajtje periodike dhe investime të planifikuara,
- mbrojtje të mjedisit dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve ujore,
- përfshirje të komunitetit dhe institucioneve në përdorim dhe mbikëqyrje.

Nga ana tjetër, menaxhimi efektiv i sistemit të kullimit nënkupton koordinim institucional, ku rolet dhe përgjegjësitë janë të qarta, si dhe vendimmarrje e bazuar në të dhëna (p.sh. nivelet e ujit, reshjet, gjendja

e kanaleve). Transparenca dhe përgjegjshmëria në administrim janë thelbësore për të shmangur degradimin e infrastrukturës dhe për të garantuar shërbim cilësor.

Ky objektiv synon krijimin e një sistemi kullimi që jo vetëm funksionon mirë sot, por është edhe i aftë të përballojë sfidat e së ardhmes, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

- Identifikimi i nevojave për ndërhyrje në sistemin e kullimit ekzistues për të ruajtur kapacitetet e projektuara, si dhe për identifikimin e nevojave për rritje të kapacitetit të kullimit.
- Identifikimi i zonave problematike lidhur me kullimin dhe marrja e masave për eliminimin e tyre (largimin e dherave dhe pastrimin e tyre nga kanalet kulluese), pasi kullimi është i rëndësishëm pasi parandalon dëmtimet në tokat bujqësore, mbron nga përmbytjet si dhe është parakusht për ujitjen e duhur).
- Evidentimi i kërkesave për shërbimet që eskavatorët kanë nevojë (remonte totale) dhe parashtrimi i këtyre kërkesave pranë MBZHR si autoriteti financues i buxhetit vjetor.
- Sigurimin e funksionimit të sistemit të kullimit nëpërmjet kryerjes së punimeve të pastrimit të kanaleve kulluese me anë të eskavatorëve.
- Monitorimi i vazhdueshëm nga Sektori Teknik dhe ai i Hidrovor - Makineri me qëllim kryerjen e punimeve në mënyrën e duhur dhe përdorimin e makinerive në mënyrën e duhur, për të siguruar ndjekjen e grafikut të punimeve të miratuar në fillim të vitit.
- Kontroll i vazhdueshëm i objekteve edhe pasi janë përfunduar punimet, në mënyrë që të sigurojë mbarëvajtjen e punës së sistemit kullues.

OBJEKTIVI 3

“Arritja e rezultateve optimal dhe të qëndrueshme të zhvillimit dhe të menaxhimit të sistemit të mbrojtjes nga përmbytjet”

Ky objektiv synon ndërtimin dhe administrimin e një sistemi të mbrojtjes nga përmbytjet që është njëkohësisht efikas në rezultate dhe i qëndrueshëm në kohë, duke garantuar sigurinë e jetës, pronës dhe aktivitetit ekonomik.

Së pari, arritja e rezultateve optimale nënkupton që masat mbrojtëse (digat, argjinaturat, kanalet kulluese, stacionet e pompimit, etj.) të projektohen dhe të funksionojnë në mënyrë sa më efikase. Kjo kërkon:

- identifikim të saktë të zonave me rrezik të lartë përmbyetjeje,
- investime të targetuara aty ku ndikimi është më i madh,
- përdorim të teknologjive moderne për parashikim dhe monitorim (p.sh. sisteme paralajmërimi të hershëm),
- mirëmbajtje të vazhdueshme për të shmangur degradimin e infrastrukturës.

Në këtë kuptim, “optimal” do të thotë jo thjesht ndërtim strukturash, por siguri që ato japin maksimumin e efektit mbrojtës me kosto të arsyeshme.

Së dyti, qëndrueshmëria lidhet me aftësinë e sistemit për të përballuar ndryshimet në kohë, si:

- intensifikimi i reshjeve dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike,
- zgjerimi urban dhe ndërhyrjet në territor,
- konsumimi natyror i infrastrukturës.

Një sistem i qëndrueshëm kërkon planifikim afatgjatë, investime të vazhdueshme, si dhe integrim të masave strukturore (si digat) me ato jo-strukturore (si menaxhimi i territorit, edukimi i komunitetit dhe kontrolli i ndërtimeve në zona të rrezikuara).

Nga ana tjetër, menaxhimi efektiv është thelbësor për arritjen e këtij objekti. Ai përfshin:

- koordinim ndërinstytucional mes autoriteteve vendore dhe qendrore,
- përdorim të të dhënave për vendimmarrje (niveli i ujërave, reshjet, historiku i përmbytjeve),
- reagim të shpejtë në situata emergjente,
- transparencë dhe përgjegjshmëri në administrimin e fondeve dhe ndërhyrjeve.

Ky objektiv synon krijimin e një sistemi të mbrojtjes nga përmbytjet që jo vetëm redukton rrezikun në mënyrë efektive sot, por është edhe i aftë të përshtatet dhe të mbetet funksional në të ardhmen, duke mbështetur zhvillimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të territorit.

- Identifikimi i veprave të mbrojtjes nga përmbytjet duke i renditur ato sipas riskut potencial, me qëllim identifikimin e problematikave kyce për të përcaktuar dhe nevojat për ndërhyrje, për të mbrojtur zonat e populluara të rrezikuara nga përmbytjet.
- Të përcaktohen prioritetet dhe të pasqyrohen në MBZHR kërkesat emergjente me qëllim mbrojtjen e tyre.
- Evidentimi i kërkesave për shërbimet që eskavatorët kanë nevojë (remonte totale) dhe parashtrimi i këtyre kërkesave pranë MBZHR si autoriteti financiar i buxhetit vjetor.

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Raporti monitorimi është kryer në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.553, datë 30.09.2021, “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”. Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën vitin 2025, rezulton se:

- D.U.K Korçë ka vijuar me përmbushjen e masave të parashikuara në Planin e Integritetit.
- Në sistemin e Ujitjes është realizuar:
 - a- Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Përmirësimit të Menaxhimit
 - b- Është rritur sipërfaqja së tokës që ujitjet bazuar në planin vjetor
 - c- Ka ndryshime në prodhimin dhe produktivitetin e kulturave si rrjedhojë e përmirësimit të infrastrukturës së ujitjes
 - d- Është rritur produktiviteti i tokave
- Në sistemin e Kullimit janë realizuar:
 - a- Ndryshime në sipërfaqet e tokave me probleme kullimi
 - b- Sipërfaqe e bonifikuar nga ujërat sipërfaqësore
- Sistemi i mbrojtjes ndaj përmbytjeve
 - a- Është ulur niveli i dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet
 - b- Është përmirësuar infrastruktura e mbrojtjes lumore
- Me qëllim kryerjen e punimeve në mënyrën e duhur, për të siguruar ndjekjen e grafikut të punimeve të miratuara nga firmat kontraktuese dhe punimeve të pastrimit të kanaleve kulluese me anë të eskavatorëve
- Kontroll i vazhdueshëm i objekteve edhe pasi janë përfunduar punimet(investimet), në mënyrë që të sigurojë mbarëvajtjen e punës në hidrovore .
- Në bashkepunim me sektorin teknik të bëjnë të mundur pastimet i hinkave hyrëse të hidrovore nga mbushjet me inerte për të qënë në gadishmeri në sezonin 15 shtator - 15 prill.

Konceptoi

Koordinatori i Integritetit

Ing.Anesti Lubonja



Aprovoi:

